



Project funded by the European Union



Proçesverbal i Takimit të 18-të të Grupit të Aktorëve
për
Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

**9 Mars 2018, Bashkia Resnjë,
Republika e Maqedonisë**

Pjesëmarrësit në takim:

Struktura e pjesëmarrësve në takimin e 18-të të Grupit të Aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” ka përfshirë 44 pjesëmarrës nga Rajoni i Prespës. Takimi u organizua dhe u lehtësua nga Stafii i Njësise së Menaxhimit të Projektit me asistencën e Presidentes të Grupit të Palëve të interesuara për rajonin ndërkufitar “Prespa”.

Lista e plotë e pjesëmarrësve dhe detaje për kontaktet e tyre mund të gjenden në:

ANNEX 1: Lista e pjesëmarrësve të takimit të 18-të të grupit të aktorëve për rajonin ndërkufitar “Prespa” 19.04.2017

ANNEX 2: PPP_ New ABD 5 phase

ANNEX 3: PPP_LEIWW Grant Scheme for Prespa cross-border region

Programi i takimit:

Takimit i 18-të i Grupit të Aktorëve Për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

09:30 – 10:00 **Mbërritja e pjesëmarrësve dhe takimi i mirëseardhjes**

10:00 – 10:15 **Fjalimi i mirëseardhjes**

*Z. Zivko Gosharevski, Kryetari i bashkisë së Resnjës
Znj. Viola Bogdani, Presidente e Grupit të Aktorëve për Rajonin “Prespa”
Z. Damjan Surlevski Projekt Menaxher SWG*

10:15 – 10:40 **Prezantim dhe diskutim rreth fazës së re ABD të Projekti të BE-së:
“Bashkëpunimi rajonal dhe rrjetëzimi në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe ekonomik të zonave ndërkufitare”**

Z. Damjan Surlevski Projekt Menaxher SWG

10:40 – 11:00 **Sesioni informues rreth rezultateve të Thirrjes Njerëzitet për Njerëzitet për Rajonin ndërkufitar Prespa**

Z. Darko Buzarovski, Menaxher Rajonal për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

11:00 – 11:20 **Prezantimi i grupeve të punës rreth iniciativave klaser për zhvillimin e sektorëve të turizmit dhe bujqësisë në rajonin e Prespës**

Znj. Etleva Thimo, Koordinatore Rajonale për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

11:20 – 11:40 **Diskutim dhe prezantim i antarëve të rinj të nominuar për grupin e aktorëve dhe aktivitetet e ardhshme**

Znj. Etleva Thimo, Koordinatore Rajonale për Rajonin Ndërkufitar “Prespa”

11:40 – 12:00 **Konkluzionet e takimit**

12:00 – 13:00 **Dreka**

Procesverbali i takimit

Takimi filloi me fjalën përshëndetëse të Projekt Menaxherit të SWG-së Z.Damjan Surlevski, i cili përshëndeti pjesëmarrësit dhe shprehu kënaqësinë për interesin dhe prezencën e lartë të antarëve të grupit të palëve të interesuara, duke konfirmuar kështu intensifikimin e bashkëpunimit midis aktorëve në rajonin Prespa përmes implementimit të qasjes ABDA. Në vazhdim ai prezantoi menaxherin e ri rajonal, Z.Darko Buzarovski dhe ftoi të gjithë pjesëmarrësit dhe antarët e rinj për një prezantim të shkurtër mbi pritshmëritë dhe prezencën e tyre në takimin e aktorëve të palëve të interesuara.

Në emër të Bashkisë Resnjë, Z. Zivko Gosharevski, kryetar i bashkisë, përshëndeti pjesëmarrësit dhe shprehu kënaqësinë për organizimin e takimit të 18-të të grupit të aktorëve në bashkinë Resnjë. Ai theksoi rëndësinë e këtyre aktiviteteve në rajon, duke shprehur mbështetjen maksimale për bashkëpunim në të ardhmen si edhe uroi një bashkëpunim sa më të frutshëm me të gjithë aktorët.

Në vazhdim, Znj. Viola Bogdani Presidente të grupit të palëve të interesuara për rajonin ndërkufitar të Prespës, falenderoi Bashkinë Resnjë për mikpritjen e takimit të 18-të të grupit të aktorëve si edhe të gjithë pjesëmarrësit për prezencën e tyre.

Pas përmbylljes së përshëndetjes projekt menaxheri i SWG-së prezantoi programin e takimit duke u ndalur në secilën prej çështjeve për tu trajtuar.

Sesioni 1

Prezantim dhe diskutim rreth fazës së re ABD të Projekti të BE-së: “Bashkëpunimi rajonal dhe rrjetëzimi në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe ekonomik të zonave ndërkufitare”

Seanca filloi me prezantimin e Z. Damjan Surlevski, projekt menaxheri i SWG-së, i cili bëri një pasqyrim të përgjithshëm të fazës së re ABD 5 të projektit të BE-së “Bashkëpunimi rajonal dhe rrjetëzimi në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe ekonomik të vendeve ndërkufitare”. Prezantimi u fokusuar në objektivat e përgjithshme dhe specifike të projektit për zbatimin e qasjes ABDA dhe implementimin e aktiviteteve në të ardhmen gjatë fazës së re të projektit. Kjo fazë e projektit të financuar nga BE: “Bashkëpunimi rajonal dhe rrjetëzimi në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe ekonomik të vendeve ndërkufitare” për rajonin ndërkufitar Prespa do të përfshijë zbatimin e një sërë aktiviteteve, si aktivitetet rajonale Njerëzit për Njerëzit, seminare dhe evente për ngritjen e kapaciteteve të aktorëve, lehtësimin e zhvillimit të aplikimeve për projekte, takime të rregullta mes aktorëve si dhe aktivitete për të rritur bashkëpunimin dhe rrjetëzimin midis përfituesve të IPA II në mënyrë që të përshpejtohet procesi i pranimit në BE të Ballkanit Perëndimor në sektorët e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Sesioni 2

Sesioni informues rreth rezultateve të Thirrjes Njerëzitet për Njerëzitet për Rajonin ndërkufitar Prespa dhe iniciativat klaser në rajonin e Prespës

Prezantimi filloi me arritjet e thirrjes Njerëzitet për Njerëzitet në të katër rajonet e “Drina – Tara”, “Drina – Sava”, “Sharra” and “Prespa”. Gjatë prezantimit u dha një informacion rreth procesit të vlerësimit dhe rezultateve kryesore mbi thirrjen e hapur për eventet Njerëzitet për Njerëzitet. Përvoja i përket rajonit ndërkufitar të Prespës u dorëzuan njëmbëdhjetë (11) projekt aplikime. Pas procesit të vlerësimit vetëm gjashtë (6) projekt aplikime rezultuan të suksesshme me pikët e nevojshme për mbështetje financiare. Ndërkohë, për shkak të fondeve të pamjaftueshme katër (4) projekt aplikime që rezultuan gjithashtu të suksesshme me pikët e nevojshme gjatë procesit të vlerësimit u vendosën në listën e pritjes për mbështetje të mundshme në të ardhmen. Vetëm një (1) aplikim për rajonin e Prespës nuk rezultoi i suksesshëm me pikë të pamjaftueshme për tu mbështetur financiarisht pas procesit të vlerësimit.

Gjithashtu, prezantimi u fokusua në diskutimin rreth progresit të punës së bërë për dy grupet e punës të themeluara në prioritetet kryesore për zhvillim të rajonit ndërkufitar të Prespës si bujqësia dhe turizmi. Prezantimi përfshiu gjithashtu aktivitetet kryesore të realizuara deri tani nga të dy grupet e punës dhe aktivitetet e planifikuara në të ardhmen sipas planit të tyre të aksionit. Gjatë diskutimit të hapur u sugjerua përfshirja e një ideje të re për një iniciativë rreth mbrojtjes së biodiversitetit dhe përfshirjen në grupin e klasterit për Përpunimin e Mollës. Në vazhdim, u sugjerua që potencialisht ato mundet të krijojnë një dokument strategjik dhe të paraqesin prioritetet për rajonin.

Përvoja i përket iniciativës së klasterit të turizmit, u theksua se fusha e mjedisit dhe turizmit po bëhet aktuale së bashku me trashëgiminë kulturore. Një pjesë e kësaj iniciative është mbledhja e të gjitha organizatave dhe iniciativave që po punojnë në mbrojtjen e rajonit ndërkufitar. Krijimi dhe konsolidimi i një grupi pune në sektorin e turizmit është i nevojshëm për rajonin e Prespës.

U theksua se këto dy grupe pune janë një nismë shumë e mirë për aktorët e palëve të interesuara për t'i ndihmuar ata të rrisin bashkëpunimin ndërkufitar dhe të krijojnë mundësi për zhvillimin e mëtejshëm të rajonit. Gjithashtu, në përfundim u theksua se Njësia e Menaxhimit të Projektit Prespa dhe SWG do të mbështesin këto iniciativa klaster në rajon dhe do të përpiqen të gjejnë fonde shtesë për mbështetjen financiare të aktiviteteve të ardhshme të dy grupeve të punës.

Sesioni 3

Sesion informues rreth arritjeve të Thirrjes së Skemës së Grantit ABD brenda projektit LEIWW

Sesioni filloi me prezantimin e Z. Darko Buzarovski Menaxher Rajonal për rajonin ndërkufitar “Prespa”, i cili bëri një prezantim të rezultateve të zbatimit të skemës së grantit ABD brenda projektit LEIWW në rajonin ndërkufitar të Prespa. Gjatë prezantimit ai dha një informacion të përgjithshëm të rezultateve finale të thirrjes së parë dhe të dytë për rajonin ndërkufitar Prespa. Në thirrjen e parë për propozime u dorëzuan pesë (5) projekt aplikime dhe vetëm një (1) u kontraktua, por u anulua për shkaqe personale të përfituesit. Gjatë thirrjes së dytë

për propozime për rajonin ndërkufitar Prespa në total ishin nëntëmbëdhjetë (19) projekt aplikime të dorëzuara, prej të cilave (10) dhjetë projekt aplikime rezultuan fituese gjatë procesit të vlerësimit dhe për shkak të fondeve të pamjaftueshme, një (1) projekt aplikim i cili rezultoi fitues gjatë procesit të vlerësimit duke plotësuar pikët e nevojshme u mbështet financiarisht me vonë. Në total njëmbëdhjetë (11) projekt aplikime u mbështetën në skemën e grantit për rajonin ndërkufitar Prespa. Gjithashtu, u theksua se projekt aplikimet e dorëzuara për rajonin e Prespës u fokusuan kryesisht në sektorin e bujqësisë dhe atë të turizimit.

Gjatë diskutimit të hapur u theksua se zbatimi i skemës së granetve ka qënë një mundësi shumë e mirë për përmirësimin e kushteve të biznesit dhe zhvillimit të integruar ekonomik të rajonit Prespa. Gjithashtu u sugjerua se në vazhdimësi pjesëmarrja e sektorit të biznesit duhet të rritet edhe më shumë dhe të jetë më aktive në grupin e palëve të interesuara për rajonin e Prespës.

Konkluzione dhe mbyllja e takimit

Në sesioni e fundit u dhanë konkluzionet si mëposhtë:

- Faza e projektit të financuar nga BE: “Bashkëpunimi rajonal dhe rrjetëzimi në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe ekonomik të vendeve ndërkufitare” për rajonin ndërkufitar Prespa do të përfshijë zbatimin e një sërë aktiviteteve, si aktivitetet rajonale Njerëzit për Njerëzit, seminare dhe evente për ngritjen e kapaciteteve të aktorëve, lehtësimin e zhvillimit të aplikimeve për projekte, takime të rregullta mes aktorëve si dhe aktivitete për të rritur bashkëpunimin dhe rrjetëzimin midis përfituesve të IPA II në mënyrë që të përshpejtohet procesi i pranimit në BE të Ballkanit Perëndimor në sektorët e bujqësisë dhe zhvillimit rural;
- Gjatë thirrjes së hapur për eventet Njerëzit për Njerëzit për rajonin ndërkufitar të Prespës u dorëzuan njëmbëdhjetë (11) projekt aplikime. Pas procesit të vlerësimit vetëm gjashtë (6) projekt aplikime rezultuan të suksesshme me pikët e nevojshme për mbështetje financiare dhe për shkak të fondeve të pamjaftueshme katër (4) projekt aplikime që rezultuan gjithashtu të suksesshme me pikët e nevojshme gjatë procesit të vlerësimit u vendosën në listën e pritjes për mbështetje të mundshme në të ardhmen. Vetëm një (1) aplikim për rajonin e Prespës nuk rezultoi i suksesshëm me pikë të pamjaftueshme për tu mbështetur financiarisht pas procesit të vlerësimit;
- Dy grupet e punës, klaster të themeluara në rajon janë një nismë shumë e mirë për aktorët e palëve të interesuara për t'i ndihmuar ata të rrisin bashkëpunimin ndërkufitar dhe të krijojnë mundësi për zhvillimin e mëtejshëm të rajonit;
- Njësia e Menaxhimit të Projektit Prespa dhe SWG do të mbështesin këto iniciativa klaster në rajon dhe do të përpiqen të gjejnë fonde shtesë për mbështetjen financiare të aktiviteteve të ardhshme të dy grupeve të punës;
- Projekt aplikimet për grant të dorëzuara për rajonin ndërkufitar të Prespës u fokusuan kryesisht në sektorin e bujqësisë dhe atë të turizimit. Në total njëmbëdhjetë (11) projekt aplikime u mbështetën në skemën e grantit për rajonin ndërkufitar Prespa. U

theksua se zbatimi i skemës së granetve ABD nën projektin LEIWW ka qënë një mundësi shumë e mirë për përmirësimin e kushteve të biznesit dhe zhvillimit të integruar ekonomik të rajonit Prespa

- Ndërkohë u sugjerua se në vazhdimësi pjesëmarrja e sektorit të biznesit duhet të rritet edhe më shumë dhe të jetë më aktive në grupin e palëve të interesuara për rajonin e Prespës;
- Njësia për menaxhimin e projektit “Prespa” dhe SWG do të vazhdojnë të shërbejnë si një pikë informative ku antarët e grupit të marrin informacione e nevojshme për thirrje të reja për projekt propozime. Ata do të vazhdojnë të mbështesin përgatitjen e aplikimeve për projekt propozime të ndryshme si edhe do të lehtësojnë partneritetet për programe aktive IPA, CBC në rajon dhe thirrje të tjera të aktive për rajonin;

Përgatiti:

Etleva Thimo, Koordinatore Rajonale për Rajonin Ndërkufitar të Prespës